



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 183, datë 13.12.2011

**PËR
MIRATIMIN E AUTORIZIMIT TË SHOQËRISË “BANKA SOCIETE
GENERAL - ALBANIA” SH.A PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI KUJDESTAR
NË LETRAT ME VLERË TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në bazë dhe për zbatim të pikës 6/c, të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të nenit 72, të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, dhe Rregullores nr. 21, datë 26.03.2009 “Për kushtet e autorizimit të kujdestarit të letrave me vlerë të Qeverisë“ me propozim të Departamentit të Licencim Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Autorizimin e shoqërisë “Banka Societe General - Albania” sh.a për të vepruar si kujdestar në letrat me vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Elisabeta GJONI**